

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Pozicioni: Koordinator/e Komunikimi dhe Marketingu (Nivel Senior)

Tipologjia: Me kohë të plotë

Afati i aplikimit: 31 Gusht 2026

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është një institucion i arsimit të lartë, i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike & IT. I njohur për qasjen inovative në arsim dhe kërkimin shkencor, UMT është institucioni i parë në Shqipëri që ka integruar Inteligjencën Artificiale në të gjitha ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare, duke ofruar një formim të orientuar drejt profesioneve të së ardhmes.

UMT është i angazhuar fuqimisht në ndërkombëtarizim, duke ndërtuar partneritete me universitete dhe institucione kërkimore në Europë dhe SHBA, si dhe në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm inovacioni dhe sipërmarrjeje, që mbështet zhvillimin e ideve dhe projekteve nga studentët dhe stafi akademik.

Në kuadër të forcimit të departamentit të Marketingut, UMT fton të aplikojnë kandidatë të kualifikuar, me eksperiencë të konsoliduar, për pozicionin Koordinator/e Komunikimi dhe Marketingu. Ky është një pozicion nivel senior që kombinon punën ekzekutive në PR dhe media, me koordinimin e përditshëm të ekipit të marketingut.

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Marrëdhënie me Median dhe Imazhi Publik

- Ndërton dhe mirëmban marrëdhënie të vazhdueshme me mediat.
- Harton dhe shpërndan njoftime për shtyp mbi arritjet akademike, kërkimin shkencor, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe aktivitetet institucionale.
- Koordinon intervista, deklaratat zyrtare dhe pjesëmarrjen e drejtuesve të universitetit në media.
- Menaxhon komunikimin në situata të ndryshme, duke mbrojtur reputacionin institucional të UMT.

Marketing dhe Promovim në Fushën e Arsimit të Lartë

- Mbështet planifikimin dhe zbatimin e fushatave promovuese për regjistrimet, veçanërisht në periudhat kyçe të vitit akademik.
- Organizon dhe mbikëqyr aktivitete publike me impakt institucional (open day, panairë karriere, ceremoni diplomimi, konferenca).
- Kontribuon në përgatitjen e materialeve promocionale që komunikojnë vlerën akademike dhe të kërkimit shkencor të UMT tek maturantët, prindërit dhe partnerët.
- Monitoron performancën e komunikimit institucional dhe përgatit raportime periodike për drejtorinë.

Marketingu për rekrutimin e studentëve

- Koordinon aktivitetet promocionale për programet Bachelor, Master dhe programet e reja të UMT-së.
- Koordinon promovimin e bursave, Open Days, afateve të aplikimit dhe aktiviteteve të tjera të rekrutimit.
- Bashkëpunon ngushtë me Admissions për koordinimin e aktiviteteve të marketingut dhe komunikimit.
- Mbështet zhvillimin e fushatave të orientuara drejt rritjes së interesit, aplikimeve dhe regjistrimeve.

- Koordinon aktivitetet promovuese për programe ndërkombëtare, Erasmus dhe iniciativa të tjera të UMT-së.

Bashkëpunime Institucionale dhe Ndërkombëtare

- Mbështet ndërtimin dhe komunikimin e partneriteteve me universitete, institucione kërkimore dhe kompani në Shqipëri e jashtë saj.
- Bashkëpunon me stafin akademik për të promovuar projekte kërkimore, konferenca shkencore dhe arritje ndërkombëtare.
- Ndhmon në forcimin e marrëdhënieve me rrjetin e alumnëve të UMT.

Koordinim i Ekipit dhe Strategjisë

- Koordinon punën e përditshme të specialistit/es së social media & content dhe specialistit/es së foto/video/design.
- Harton dhe mban kalendarin e përbashkët editorial, duke siguruar përputhje mes njoftimeve PR, kanaleve sociale dhe materialit vizual.
- Siguron konsistencë të mesazhit dhe identitetit institucional në të gjitha kanalet e komunikimit (web, rrjete sociale, media, materiale printi).
- Përcakton, bashkë me departamentin e PR&Marketing dhe eprorët, prioritetet mujore dhe afatgjata të departamentit të Marketingut dhe PR-it.
- Drejton takime të rregullta koordinimi me ekipin e marketingut.

Kriteret kryesore për të aplikuar

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Marketing, Komunikim, Marrëdhënie me Publikun, Menaxhim Biznesi ose fusha të ngjashme.
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në marketing dhe/ose PR, me përparësi eksperiencë në institucionet arsimore/arsimin e lartë.
- Të ketë eksperiencë në marrëdhënie me median dhe/ose komunikim institucional.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të domosdoshme për komunikim me partnerë ndërkombëtarë.
- Të ketë aftësi të forta lidhshipi dhe koordinimi ekipi, edhe pa qenë domosdoshmërisht në pozicion drejtues formal.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, negocimi dhe menaxhimi të situatave delikate.
- Të ketë aftësi organizative të nivelit të lartë dhe kapacitet për të menaxhuar disa projekte njëkohësisht.
- Të jetë proaktiv/e, i/e orientuar drejt rezultateve dhe i/e aftë të punojë si në mënyrë të pavarur, ashtu edhe në bashkëpunim të ngushtë me ekipin.

Aftësitë teknike

- Aftësi shumë të mira në Excel/Google Sheets dhe në përgatitjen e raporteve dhe dashboard-eve.
- Aftësi të mira analitike dhe kuptim të KPI-ve të marketingut.
- Njohuri të mira të marketingut digjital dhe treguesve të performancës së fushatave.
- Njohuri të Google Analytics ose platformave të ngjashme përbëjnë avantazh.
- Njohuri të sistemeve CRM dhe lead management përbëjnë avantazh.

- Njohuri të mira të platformave të komunikimit digjital dhe rrjeteve sociale.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- CV (Curriculum Vitae)
- Letër motivimi

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al

Pas selektimit do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.